



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:018805
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05482878

C-IV-17-0448

Paditësja; X B, -Deçan

Kundër

Palës së paditur; Agjencia Kosovare e Privatizimit rruga Dritan Hoxha nr.55, Lakrishtë-Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit Asllan Krasniqi, me datën; 21.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

1. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadija e ushtruar nga X B vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj vendimi me shkrim me numër PEJ002-0013, i datës 28.08.2017, i lëshuar nga AKP.
2. Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me datën 22.09.2017, pranë DHPGJS, është parashtruar padi nga X B kundër palës së paditurës Agjencisë Kosovare të Privatizimit ndaj vendimit me shkrim me numër PEJ002-0013, të lëshuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit me të cilën ka kërkuar kompensimin e aksioneve në shumën prej 31,194.00 € nga Autoriteti i Likuidimit i NSH APIKO (në likuidim).

Pala paditëse ndër të tjera ka theksuar se ka qenë punëtore e NSH APIKO me kontratë të përhershme dhe se këtë fakt mund ta argumentoj Drejtori i Ndërmarrjes. Pranë Autoritetit të Likuidimit ka parashtruar kërkesë kreditore dhe se Autoriteti i Likuidimit kërkesën e parashtruar e ka refuzuar si të pa bazuar. Aplikimi i nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar është absurd ngase ky ishte ligj komunist i cili është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Me vendimin e kontestuar i është mohuar e drejta e paraparë me nenin 40.1.6 të Shtojcës së Ligjimit me numër 04/L-034 për AKP-në.

Me tutje ka theksuar se nuk qëndron pretendimi i të paditurës e cila ka theksuar se paditësit i është shuar marrëdhënia e punës kjo për faktin se paditësi ka pasur marrëdhënie të përhershme pune në Ndërmarrje. Me tutje ka shtuar se dokumenti i lëshuar nga Z. R M zyrtar i AKM-së argumentohet edhe nga Drejtori z. Y J që ka të bëjë me këtë subjekt ekonomik vërtetohet se NSH APIKO është Shoqëri aksionare.

Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta aprovoj si të bazuar dhe me aktgjykim ta anuloj vendimin e Autoritetit të Likuidimit dhe paditëses t'i njihet e drejta në kompensim monetar bazuar në dispozitat ligjore.

Kësaj padie parashtruesi si provë i ka bashkëngjitur:

- *Vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PEJ002-0013, me të cilin është refuzuar kërkesa për kompensim të aksioneve.*

Me datën 12.10.2017, AKP-ja përmes përfaqësuesit të sajë ka paraqitur mbrojtjen e saj ndaj padisë së ushtruar nga pala paditëse,ku ndër të tjera ka theksuar se NSH APIKO (në likuidim), ka hyrë në procedurën e likuidimit me datën 22.02.2017. Me datën 24.04.2017, ka parashtruar kërkesë përmes të cilës ka kërkuar pronësi të aksioneve në vlerën prej 31,194.00 €. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur se kërkesa e parashtruar nuk përmban dëshmi të mjaftueshme për ta mbështetur kërkesën andaj i ka dërguar paditësit kërkesë për parashtrimin e dëshmime plotësuese për ta mbështetur kërkesën. Paditësit nuk ka dorëzuar dëshmi shtesë, andaj Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga pala paditëse në atë procedurë dhe me vendimin me numër PEJ002-0013, kërkesën e parashtruar nga i njëjti e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar.

Me tutje në mbrojtjen e parashtruar ka theksuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe drejtë ka zbatuar edhe dispozitat ligjore. Paditësi me kërkesë ka kërkuar pronësi në aksione në vlerën prej 31,194.00 euro. Meqenëse nuk kishte ofruar dëshmi të mjaftueshme për ta mbështetur kërkesën Autoriteti i Likuidimit ka kërkuar dëshmi shtesë. Pala paditëse në përgjigjen e dhënë pohon se nuk posedon të gjitha dëshmitë e kërkuara nga e paditura. Me tutje ka shtuar se statusi i Ndërmarrjes është NSH dhe nuk është Shoqëri Aksionare. Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që padinë e parashtruar nga pala paditëse ta refuzoj si të pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit në pajtim me nenin 70.4 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-033.

Arsyetimi Ligjor

Në bazë të nenit 76 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të Kosovës, gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore. Pas shqyrtimit të provave të lëndës parashtrimeve dhe pretendimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundimin se padia e ushtruar në këtë çështje juridike është e pa bazuar.

Pas shqyrtimit të pretendimeve,parashtrimeve dhe provave të lëndës gjykata ka gjetur se pala paditëse me datën 24.04.2017, ka parashtruar një kërkesë pranë Autoritetit të Likuidimit, përmes së cilës ka kërkuar pronësinë në aksione dhe se ka pretenduar se NSH është shoqëri aksionare. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga pala paditëse në atë procedurë dhe me vendimin me numër PEJ002-0013, të datës 28.08.2017, kërkesën e parashtruar nga pala paditëse e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar.

Paditësi ka pretenduar se ka qenë punëtorë në NSH-së me kontratë të përhershme të punës,si dhe ka pretenduar në pronësi në aksione. Në anën tjetër pala e paditur e ka kontestuar padinë duke thekuar se në rastin konkret NSH-ja nuk është shoqëri aksionare përkundër përpjekjeve që janë bërë për ta bërë një gjë të tillë dhe se pala paditëse nuk ka prezantuar prova për ta argumentuar pretendimin se saj.

Me nenin 322 paragrafi 1 të LPK-së, është e përcaktuar se “në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës. Po ashtu dhe paragrafin 2 të të njëjtit nen është e përcaktuar se “pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”.

Në rastin konkret gjykata pas shqyrtimit të provave të lëndës ka ardhur në përfundimin se paditësi nuk ka parashtruar prova të mjaftueshme në lidhje me kërkesën e pretenduar, respektivisht nuk i ka argumentuar pretendimet e dhëna me padi, andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e lartë cekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës;

Në bazë të nenit 62 paragrafi 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës secila palë do ti heqë shpenzimet e veta.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda 15 ditësh, llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari;
Asllan Krasniqi